



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.09.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2446/14, për z. Musa Nikqi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Pejës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2446/14, për z. Musa Nikqi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Pejës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Nikqi, është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik si Anëtar i Kuvendit të Komunës së Pejës dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “N.T.T. Feniks – Tours”.

Fillimisht z. Nikqi është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Pastaj ai është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t’i sqaruar këtë situatë dhe për t’i dhënë rekomandimet për shmangien e konfliktit të interesit.

Në këtë takim ai është njoftuar për kufizimin në ushtrimin e funksionit publik që parasheh LPKI dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që në afat të caktuar të emëroj një person të besueshëm për të menaxhuar biznesin e tij privat.

Ndërkohë z. Nikqi ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 3051/14), me të cilën vërtetohet se ka emëruar një person të besueshëm si person të autorizuar në biznesin e tij privat. Me këtë iu ka përmbajtur rekomandimit të AKK-së dhe ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

